



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 135

Datë: 21.03.2022

PROCESVERBAL

i mbledhjes së dytë (II) të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Malishevës

RENDI DITËS

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes inauguruese datë: 01.12.2021, mbledhjes së jashtëzakonshme datë: 17.12.2021 dhe mbledhjes së jashtëzakonshme datë: 28.12.2021.
2. Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa.
3. Themelimi i Komitetit për Komunitete.
4. Formimi i Komisionit për harimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Malishevës për vitin 2022.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/46 datë: 13.01.2022 të Kryetarit të Komunës, për marrjen e vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
6. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për Stacionin e Autobusëve në Malishevë.
7. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 25.01.2022 dhe filloi në ora: 10:15. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 30 asambleistë, kryetari, drejtorë komunal, përfaqësues të KFOR-it Zviceranë, qytetarë nga komuna e Malishevës dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i kuvendit komunal të Malishevës z.Argjend Thaçi.

Argjend Thaçi: I nderuar kryetar i komunës z.Ekrem Kastrati, të nderuar kabinet qeverisës, të nderuar asambleistë dhe gjithë ju të pranishëm në sallë, përshëndetje për të gjithë ju dhe mirë se keni ardhur në mbledhjen e dytë të jashtëzakonshme të asmblesë komunale!

Fillimisht do të bëhet betimi i antarëve më të rinjë të kuvendit. **Ju ftoj që të ngriteni në këmbë dhe të bëni betimin si antarë të kuvendit.**

Unë, betohem se do t'i kryej me nder dhe besnikëri, pa anime dhe me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtrojë autorizimet e mia si këshilltarë i Kuvendit të Komunës së Malishevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për një jetë të qetë për të gjithë.

Të nderuar asambleistë, ju dëshiroj punë të mbarë dhe suksese!

Shkojmë në votim për rendin e ditës. Kush është për?

Për: 30

Me vota unanime, aprovohet rendi i ditës.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes inauguruese me datë: 01.12.2021, mbledhjes së jashtëzakonshme datë: 17.12.2021 dhe mbledhjes së jashtëzakonshme datë: 28.12.2021. Hapi debat rreth kësaj pike. Kush e do fjalën? Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: Përshëndetje për të gjithë!

Kërkoj nga sekretaria që të bëjë një përmirsim, ku thuhet që nga radhët e LDK-së propozohet Argjend Thaçi. Kjo nuk qëndron dhe duhet të bëhet përmirsim, që të shënohet i vetë propozuari Argjend Thaçi.

Argjend Thaçi: Është antarë i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe nuk mund të ja mohoni këtë të drejtë një antari.

Kush është për miratimin e procesverbaleve?

Për: 19

Kundër: 11

Abstenim: 0

Me 19 vota për, 11 kundër dhe asnjë abstenim, aprovohen procesverbalet e mbledhjes inauguruese datë: 01.12.2021, mbledhjes së jashtëzakonshme datë: 17.12.2021 dhe mbledhjes së jashtëzakonshme datë: 28.12.2021.

Kalojmë në pikën e dytë: Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa. Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet nga 7 antarë. Është e rëndësishme të merret parasysh kuota gjinore.

2 antarë i takojnë Nisma-s, 2 antarë PDK-së, 1 antarë LDK-së dhe 1 antarë VV-së.

Urdhëro, Eqrem!

Eqrem Morina: Unë, kam një kërkesë, që si antarë nga AAK të jem pjesë e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Argjend Thaçi: Në konsultimet që i kemi bërë me MAPL-në, Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet nga grupet politike 3 antarë dhe më shumë. Për sqarim ftoj Muaharemin ta merr fjalën.

Muharrem Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Sa i përket përcaktimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, ky komitet përbëhet prej 7 antarëve. Komiteti prej 7 antarëve nënkupton që kryesuesi shkon zyrtarisht si kryesues i Komitetit për Politikë dhe Financa. Një konsultim dhe me partnerët tanë bashkëpunues OSBE-në, kemi një formulë e cila merret dhe me përcaktimin e ndarjes së vendeve dhe për asamblen. Në bazë të kësaj formule që e kemi përgaditur, kemi 6 antarë, 2 antarë nga Nisma, 2 antarë nga PDK-ja, 1 antarë nga LDK-ja dhe 1 antarë nga VV-ja.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Përshëndetje për të gjithë! Meqenëse është seanca ime e parë në këtë legjislaturë, më lejoni që të ju uroj zgjedhjen si antarë komunal, poashtu uroj kryesuesin dhe drejtorët komunal.

Sa i përket kësaj çështje të themelimit të komisionit për Politikë dhe Financa i kemi dy mekanizma ku bazohemi për komunitet. Është Ligji për Vetëqeverisjen Lokale dhe Udhëzimi Administrativ nr.05/2020. Ky Udhëzim Administrativ ka 3 pika: 1. Komiteti për Politikë dhe Financa duhet t'i përfaqësojë të gjitha subjektet politike, pra çdo parti politike duhet të ketë nga një antarë në këtë komitet. 2. Varësisht prej përqindjes, secili grup politik duhet t'i ketë aq antarë, varësisht prej përqindjes se sa i ka si grup. Pra, kemi dy formula, sipas formulae që e prezantoj zyrtari ligjor i kuvendit, ose sipas kësaj formule që secili subjekt të ketë nga një antarë në KPF-ë. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Kush është për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa sipas kësaj formule: dy antarë nga Nisma, 2 antarë nga PDK-ja, 1 antarë nga LDK-ja dhe 1 antarë nga VV-ja?

Për: 30

Me vota unanime, themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa.

Shkojmë me propozime për Komitetin për Politikë dhe Financa. Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Grupi parlamentar i Nisma-s, për antarë në Komitetin për Politikë dhe Financa, propozon Rukije Bytyqi dhe Valon Mazrekun.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Mirëllinda!

Mirëllina Gashi: Përshëndetje për të gjithë! Meqenëse është fjala ime e parë në këtë legjislaturë, ju uroj suksese të gjithëve, kryetarit, kryesuesit dhe drejtorëve dhe pse po shohë shumë pak zonja ju uroj shumë suksese punë të mbarë dhe ta keni parasysh gjithmonë qytetarin.

Grupi jonë nga PDK-ja, propozon Arlindë Rudi dhe Nebih Bibaj për antarë në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Argjend Thaçi: Urdhëroni nga LDK-ja!

Adile Hoxha: Ne nga Lidhja Demokratike e Kosovës, për Komitetin për Politikë dhe Financa, propozojmë Labinot Gashin.

Argjend Thaçi: A ka propozime tjera nga grupi i LDK-së. Si antari i Lidhjes Demokratike të Kosovës propozoj që në Komitetin për Politikë dhe Financa, antarë të jetë Hamit Lima.

Labinot Gashi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit!

Unë pajtohem me atë që e tha Halili, që ne nuk guxojm me dalë jashtë asaj që na përcakton Ligji për Vetëqeverisjen Lokale dhe Udhëzimet Administrative, ku tha që në KPF-ë përfaqësohen subjektet politike, respektivisht grupet e asambleistëve. Për me siguri stabilitet dhe normalitet në këtë kuvendi, kryesuesi është dashur ta kërkoj deklarin e grupeve, sepse ka lëvizje të asambleistëve. Në emër të subjekteve politike flasin subjektet politike dhe nuk është çështje individuale. Ju e keni një komunikatë të LDK-së, për shkak të veprimeve të asambleistëve dhe në emër të subjektit të LDK-së dega në Malishevë flas unë si Labinot Gashi bashkë me kolegët e mi. Ju kisha lutur, mos krijoni situata të pa këndshme në këtë kuvend, sepse çështjet politike të brendshme që i kemi, mundemi me zgjidh jashtë këti kuvendi, sepse kuvendi nuk është për ballafaqime. Në emër të LDK-së flasim ne dhe jo dikush tjetër.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Agnesa!

Agnesa Kastrati: Përshëndetje për të gjithë! Ne si grup i asambles së Lëvizjes Vetëvendosje propozojmë Veton Zogaj për antarë të Komiteti për Politikë dhe Financa.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë kolegët e asambles komunale!

Sa i përket çështjes së propozimeve për Komitetin për Politikë dhe Financa, nëse paska një rregullore e cila nuk ju ndalon dhe antarëve të vetëpropozohen, ndoshta dhe shumë antarë të tjerë kanë dëshirë të jenë pjesë e komitetit që të kontribuojnë në të. Unë mendoj që nuk ka një rregullore psh për secilin antarë, kjo është në grupe ku secili grup e jep propozimin dhe vazhdohet tutje në pako. Në njëfarë forme na imponohet neve si antarë të kuvendit dhe si grupe që ta unifikojm situatën, ta harmonizojmë dhe të gjithë antarët t'i votojmë me pako, përndryshe i humb kuptimi që subjektet të jenë të përfaqësuar aty. Pra, nëse është një rregullore e cila antarëve nuk ju ndalon, atëherë mendoj që ka dhe shume propozime tjera, prej shumë antarëve që të jenë pjesë e KPF-së.

Argjend Thaçi: Duhet të kemi parasysh dhe kuotën gjinore. Kërkoj mirëkuptimin e juaj, sepse me këtë format nuk na lejohet që të votojmë. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Ju që i keni nga dy antarë NISMA, PDK-ja dhe ju që jeni në kualicion me Nismen ju takon ta bëni një lëshim, që në Komitetin për Politikë dhe Financa të propozoni dy gra dhe në Komitetin për Komunitete ne dhe LDK-ja që e kemi nga një antarë të sigurohemi që ta propozojmë nga një femër. Mos të kemi bllokadë, që të na kthej prapë MAPL-ja.

Argjend Thaçi: Për shkak të problemeve teknike, shkojmë në një pauz.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Për mos me marr vendime të paligjshme, ne po e bëjmë një lëshim dhe e tërheqim kandidaturën e Valon Mazrekut dhe e vendosim Gentianë Hoti.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi: Unë kërkoj dhe një herë sqarim nga këshilltari, ose a ka ndonjë rregullore që nuk ja ndalon secilit antarë me u propozu në këto komitete.

Argjend Thaçi: Në kuvend është e lejuar të propozohet, a miratohet a jo është çështje tjetër.

Valon Krasniqi: Dhe unë vetëpropozohem për Komitetin për Politikë dhe Financa, nga subjekti me të cilin e kam fituar mandatin dhe nga subjekti në të cilin jam i certifikuar në KQZ-ë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Kryesues, duhet të ftohet secili subjekt që të deklaroj grupin dhe shefin e grupit. Unë, si shef i grupit nga VV-ja e prezantoj grupin prej sa antarëve përbëhet, kush është shef i grupit dhe propozimet bëhen prej atyre antarëve. Antari në KPF-ë dhe antari në Komitetin për Komunitet propozohet vetëm nga Vetëvendosja, ndërsa në komitetet tjera mund të propozohet Valoni nëse kanë marrveshje tjera.

Argjend Thaçi: Shkojmë në votim. Votohen antarët e propozuar nga Nisma Socialdemokrate Rukije Bytyqin dhe Genianë Hoti. Kush është për?

Për: 31

Me vota unanime, Rukije Bytyqi dhe Gentianë Hoti bëhen pjesë e KPF-së.

Shkojmë në votim. Votohen antarët e propozuar nga Partia Demokratike e Kosovës Arlindë Rudi dhe Nebih Bibaj . Kush është për?

Për: 31

Me vota unanime Arlindë Rudi dhe Nebih Bibaj bëhen antarë të KPF-së

Shkojmë në votim për propozimet e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Kush është për, që Hamit Lima të jetë antarë i KPF-së?

Për: 16

Me 16 vota për Hamit Limaj bëhet pjesë i KPF-së

Kush është për që Labinot Gashi të jetë pjesë e KPF-së?

Për: 15

Me 15 vota për Labinot Gashi nuk bëhet pjesë i KPF-së

Kush është për antarin e VV-së Veton Zogaj?

Për: 25

Kundër: 2

Abstenim: 4

Me 25 vota për, 2 kundër dhe 4 abstenime, Veton Zogaj bëhet pjesë e KPF-së

Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa është:

1. Argjend Thaçi - LDK-Kryesues
2. Rukije Bytyqi - Nisma Socialdemokrate -antare
3. Genianë Hoti - Nisma Socialdemokrate - antare
4. Arlindë Rudi - PDK- antare
5. Nebih Bibaj - PDK- antarë
6. Hamit Limaj - LDK- antarë
7. Veton Zogaj - VV- antarë.

Votohet në tërsi kjo përbërje e Komitetit për Politikë dhe Financa. Kush është për?

Për: 27

Kundër: 4

Abstenim: 0

Me 27 vota për, 4 kundër dhe asnjë abstenim, themelohet Komiteti për Politikë dhe Financa i përbërë prej 7 antarëve.

Urdhëro, Labinot!

Labinot Gashi: Kur filloi procedura e zgjedhjes së KPF-së e thatë shumë saktë Udhëzimin Administrativ në bazë të cilave zgjedhen dhe i përfaqësojnë subjektet politike. Kjo çka po ndodhë këtu jeni duke bërë shkelje mbas shkelje. Ja keni nisur seancën e parë me shkelje është vërtetuar. Unë do të drejtohem tek organet kompetente për mënyrën se çka jeni duke bërë ju sot. Ju në këtë formë nuk mundeni me pas qasje të bashkëpunimit, por, po dëshironi me kriju situata që asnjëherë në këtë kuvend të Malishevës nuk kanë qenë. Është mandati i tretë i imi në këtë kuvend dhe çdo herë në KPF-ë janë përfaqësu shefat e grupeve parlamentare, pavarësisht problemeve që mundemi me i pas ne. Unë mendoj që dhe në këtë rast ka shkelje, mirëpo jeni duke vepruar me logjik të numrave, ja pafshi hajrin. Tani e tutje në emër të LDK-së, ne e lëshojmë seancën dhe ju vazhdoni punë të mbarë e suksese.

Sallën e lëshojnë: Labinot Gashi, Zamire Morina dhe Adile Hoxha

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Para se të kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, kisha kërkuar që të ftohen shefat e grupeve që t'i prezantojnë grupet e tyre, mos të ketë keqkuptime dhe njerëz që thirren në emër të grupit të caktuar dhe vetëpropozohen.

Argjend Thaçi: Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës: Themelimi i Komitetit për Komunitete. Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Së pari ne të koncentrohemi te pjesa e votimit, se sa antarë do të jetë përbërja e Komisionit, 5 apo 7 antarë sa vendos kuvendi. Në praktikën e kaluar dy vende ju kemi lënë komuniteteve dhe 5 antarë kanë qenë brenda kuvendit, ku janë përfaqësuar gjitha partitë politike, për shkak se ka pasur një përfaqësim më të gjërë. Unë propozoj se dhe tani të jetë e njejta formë e vazhdimit të kësaj procedure.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Ne i kemi dy mënyra që të caktojm numrin e këti komiteti. 3 antarë të kuvendit dhe 2 minoritete, ose 5 antarë të kuvendit dhe 2 minoritete. Duhet të vendosim për 5 apo 7 antarë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Meqenëse Komuniteti për Komunitet është komitet obligativ, ne mendojm që është më mirë të shkohet me 5 antarë të kuvendit dhe 2 antarë që vinë nga komunitetet.

Argjend Thaçi: Shkojmë në votim që komiteti të jetë në përbërje prej 7 antarëve.

Kush është për?

Për: 28

Kundër: 0

Abstenim: 0

Me 28 vota për Komiteti për Komunitete përbëhet prej 7 antarëve.

Halil Morina: Duhet të shkohet për secilin grup nga sa antarë i takojnë, në bazë të përqindjes.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi: Meqenëse në këtë Komitet të Komunitet do të jenë 5 antarë, përparsia shkon tek subjekti më i madh parlamentar i cili është dalur nga zgjedhjet, pastaj sipas radhës. Sa i përket këti komiteti unë e kam një propozim, që antarë për këtë komunitet të jetë dhe Arlind Morina, prej listës së përbashkët që e kemi marrur mandatin si Lëvizje Vetëvendosje dhe Lista Guxo.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Kryesues, unë para kësaj pike kërkoja që secili subjekt të deklarojë grupin e vetë. Të deklarohen grupet paraprakisht dhe shfatet e grupeve. Në emër të Vetëvendosjes, si shëf i grupit propozoj unë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Unë e bërë dhe më herët propozimin, që në këtë komision të përfshihen 5 antarë nga kuvendi dhe të gjitha partit politike të jenë të përfaqësuar në këtë komunitet. Ky është një propozim i imi dhe kam dëshirë ta hudhesh në votim. Faleminderit!

Muharrem Morina: Në Udhëzimin Administrativ që ne u thirrur ka qenë 5 deri në 7, ndërsa Udhëzimi i vitit 2020 neni 8, pika 4 thotë në komunat ku nuk ka komunitet shumicë, Komiteti për Komunitete përbëhet jo më shumë se 5 antarë. Në Udhëzimin që u thirrur ne bashkë me ju është Udhëzimi nr.2 -2018 . Neni 7 thotë përbërja e Komitetit për Komunitete paragrafi 2 dhe 3 i neni 9 të Udhëzimit Administrativ 3-2014 që e ka shfuqizuar atë më herët, Komiteti për Komunitete përbëhet prej 5 deri në 7 antarë dhe mbi këtë procedurë ne hym në votim dhe ju u përcaktuar për 7 antarë. Mirëpo, momentalisht në fuqi është një Udhëzim tjetër nr.5/2020. Në Udhëzimin e ri në përbërjen e Komitetit për Komunitete paragrafi 4 thotë se në komunat ku nuk ka komunitete shumicë, Komiteti për Komunitete përbëhet prej 5 antarë.

Halil Morina: Në bazë të përqindjes së antarëve të kuvendit që i kemi si grup i asambleistave, na takojnë dy antarë të kuvendit, mirëpo meqë Aleanca për Ardhmërin e Kosovës po jetë jashtë si grup, unë pajtohem që secili subjekt politikë të ketë përfaqësim në atë komitet. Meqenëse jemi 5 subjekte politike, me marrveshje politike dëshirojmë me u përfaqësu secili subjekt politikë. Si antarë të Komitetit për Komunitetë nga Nisma Socialdemokrate propozojmë Amrush Helshani.

Argjend Thaçi: Urdhëroni nga PDK-ja!

Burim Paqarizi: Përshëndetje për të gjithë! Ne si grup parlamentar nga Partia Demokratike për Komitetin për Komunitete, propozojmë Alban Kastratin.

Argjend Thaçi: Nga LDK-ja kush e do fjalën.

Hamit Lima: Ne nga radhët e LDK-së propozojmë Adile Hoxha.

Argjend Thaçi: Nga Vetëvendosja kush e do fjalën.

Veton Zogaj: Ne si Vetëvendosje për Komitetin për Komunitete propozojmë Agnesa Kastratin.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi: Kryesues, përderisa vetes nuk ja mohove të drejtën me propozu në emër të LDK-së dhe unë propozoj që dhe Arlind Morina të jetë pjesë e komitetit në kuadër të listës së përbashkët dhe si na njeh KQZ-ja për momentin.

Argjend Thaçi: Urdhëroni nga AAK-ja kush e do fjalën.

Donjete Shijaku: Përshëndetje për të gjithë! Ne nga radhët e AAK-së, në Komitetin për Komunitete propozojmë Eqrem Morina:

Veton Zogaj: Prej subjektit të Vetëvendosjes unë jam shefi i grupit dhe une i japi propozimet. Për respektim të kuotës gjinore unë propozova Agnesa Kastratin, dhe nga Vetëvendosje propozim tjetër nuk ka. Ai është asambleistë i pavarur dhe shef i Vetëvendosjes jam unë dhe asambleistë të Vetëvendosjes janë Agnesa Kastrati dhe Arbnore Hoti.

Argjend Thaçi: Shkojmë në votim. Kush është për propozimin e Veton Zogaj, që Agnesa Kastrati të jetë pjesë e Komitetit për Komunitete?

Për: 11

Kundër: 14

Abstenim: 3

Me 11 vota për, 14 kundër dhe 3 abstenime, Agnesa Kastratin nuk kalon

Kush është për propozimin e Valon Krasniqit, që Arlind Morina të jetë pjesë e Komitetit për Komunitete?

Për: 16

Kundër: 3

Abstenim: 10

Me 16 vota për, Arlind Morina bëhet pjesë e Komitetit për Komunitete.

Pjesë e Komitetit për Komunitete janë:

Amrush Helshani - NISMA,

Alban Kastrati - PDK-ja,

Eqrem Morina - AAK,

Adile Hoxha - LDK,

Arlind Morina - VV.

Meqenëse nuk e kemi kuotën gjinore, kërkoj mirëkuptimin e juaj. Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Ajo çka më shqetëson mua sepse po bim në situata të palakmueshme, ku në emër të grupeve të partive të ndryshme politike po ka probleme, kjo dhe neve po na sjellë në situatë jo të mirë. Ju kisha lutur këtyre grupeve që kanë probleme brenda vete që nëse i zgjidhin këto probleme, na bëjnë nder ne dhe kuvendit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Është keq për ne që po bim në lajthitje dy herë, për problemin e grupeve parlamentare në mes vete dhe ne nuk jemi kundër asnjë antari që propozohen këtu, sepse kanë të drejtën e përfaqësimit, mirëpo kjo punë neve po na shkakton problem. Është mirë të definohen subjektet politike, ato që janë dalë prej zgjedhjeve dhe grupet e formuara më vonë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlind!

Arlind Morina: Përshëndetje për të gjithë! Ne jemi duke jetuar në demokraci, dhe t'i nuk mundesh mem përjashtu, sepse vota qytetare më ka sjellë këtu. T'i je ardhë me votë direkte, kurse une kam ardhë me votë të qytetarit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Eqrem!

Eqrem Morina: Donjeta nuk dëshiron të merr pjesë në asanjë komision dhe për atë më propozoj mua.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Kryesues, procedura është shumë e thjeshtë dhe shumë e qartë. Në emër të Vetëvendosjes flas unë si shef i grupit dhe askush tjetër nuk mund të jap propozime. Në rastin paraprak, te çështja e KPF-së ju kërkoja mirëkuptim që në komitetin për komunitete ne propozojmë një grua dhe plotësohet kuota gjinore. Nëse dëshironi ju sjellë dhe vendimin që këta dy antarë nuk janë pjesë e grupit tonë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Meqenëse, ne grupi i Nismas, të gjithë asambleistët e gjinisë femrore i vendosum në komisione, po qudim me PDK-në, që po tregojnë si një parti e djathtë konservatore dhe nuk e di këto zonja si nuk po e lëshojnë dhe me dalë me një grup të pavarur.

Argjend Thaçi: Udhëro, Mirëllinda!

Mirëllinda Gashi: Faleminderit i nderuar!

Partia Demokratike e Kosovës gjithmonë i ka dhënë përparsi gruas dhe vajzave, mirëpo t'i kur erdhe në fillim the që ne NISMA dëshirojmë të japim përparsi gjinis femrore. Në këtë rast, fillo nga qeveria e NISMA-s në komunën e Malishevës, i kemi vetëm dy drejtoresha. Unë kisha kërkuar prej teje mos fol në emër të PDK-së. PDK-ja është e qartë i ka qëndrimet e saja. Problemet që po ndodhin brenda partive, le t'i zgjedhin dhe do ecim përpara. Në komisionet tjera do të japim emrat e zonjave dhe zonjushave që i kemi ne në Partinë Demokratike.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Unë flas në emër të Nisma-s dhe unë kam drejtë me i gjyku dhe me i analizu vendimet e secilit subjekt politikë, siç ka të drejtë secili antarë tjetër i kuvendit me i gjyku ose me kontestu një pikpamje tonë .

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Halil, ju e keni propozimin konkret, Vetëvendosja e propozoj një grua. Nëse ju dëshironi ta futni Arlindin vetëm pse e keni një marrveshje në komitete, athëherë bëja vendin në komitete të tjera. Arlindi, nuk mundeni me kamoflu në emër të Vetëvendosjes. Prozimi ishte konkret nga Vetëvendosja, që është Agnesa Kastrati.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlind!

Arlind Morina: Për shkak të kuotës gjinore unë do tërhiqem. Ka kaluar koha e 17 tetorit të zgjedhjeve që këta na kanë kufizuar në list në zgjedhje. Nëse kam interes të shkojë me ndonjë komision, shkojë me vota.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Për mua grupi i Vetëvendosjes është si çdo grup tjetër. Arrit me ba grupin siç duhet, në mënyrë që mos me na sjellë në këso situata. Zgjidhi problemet e juaja, pastaj ne e kemi më të lehtë.

Argjend Thaçi: Shkojmë në votim. Votohet propozimi i Veton Zogaj për Agnesa Kastratit. Kush është për?

Për: 23

Kundër: 0

Abstenim: 4

Me 23 vota për, asnjë kundër dhe 4 abstënime, Agnesa Kastrati bëhet pjesë e Komitetit për Komunitete.

Antarët e Komitetit për Komunitete janë : Amrush Helshani, Alban Kastrati, Adile Hoxha, Agnesa Kastrati, Eqrem Morina, Naser Malisheva dhe Muharrem Islamaj.

Kush është për, që ky komision të votohet në tërsi?

Për: 27

Me 27 vota për u themelua Komiteti për Komunitete.

Shkojmë me pikën e 4 të rendit të ditës: Formimi i Komisionit për hartimin e Planit të punës së kuvendit të komunës së Malishevës për vitin 2022. Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Prej praktiva të kaluara ky komision është themeluar prej shefave të grupeve.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Kryesues dhe unë pajtohem që praktika e kaluar ka qenë e mire, sepse shefat e grupeve i raportojnë grupeve të tyre.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Dhe unë pajtohem me Halilin dhe Nebihun që të ndiqet praktika e viteve të kaluara, që shefat e grupeve të hartojnë këtë plan.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit!

Hamit Limaj: Dhe ne pajtohem që të jetë shefi i grupit Labinot Gashi.

Argjend Thaçi: Urdhëroni nga PDK!

Arlindë Rudi: Nga PDK-ja propozojmë Mirëllinda Gashi.

Argjend Thaçi: Urdhëro, nga Vetëvendosje!

Agnesa Kastrati: Ne nga Vetëvendosje propozojmë Veton Zogaj.

Argjend Thaçi: Urdhëroni nga AAK-ja

Donjete Shijaku: Nga AAK-ja propozojmë Eqrem Morina.

Argjend Thaçi: Përbërja e Komitetit për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit është:

Argjend Thaçi- Kryesuesi i kuvendit,

Halil Morina nga NISMA

Mirëllinda Gashi nga PDK-ja

Labinot Gashi nga LDK-ja

Veton Zogaj nga Vetëvendosje

Eqrem Morina nga Alenaca dhe një antarë shkon nga zyra e kryetarit.

Kush është për?

Për: 27

Me 27 vota për, aprovohet themelimi i Komitetit për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit komunal të Malishevës.

Kalojmë në pikën e 5 të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/46

datë:13.01.2022 të kryetarit të komunës, për marrjen e vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Ftoj kryetarin që të bëjë prezantimin.

Ekrem Kastrati: Faleminderit, Kryesues! Të nderuar antarë të kuvendit komunal, qytetarë të dashur të komunës së Malishevës!

Sot unë paraqes kërkesën time me nr. të protokolit 01/46 të datës: 13.01.2022 për marrjen e vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Themelimi i këtij këshilli është obligim i çdo komune në nivel Kosove, për faktin se është kategori kushtetuese e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe që themelohet në bazë të Udhëzimeve Administrative nr.27/2012 të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe me nr. 03/2012 të MAPL-së për këshillat komunal për siguri dhe bashkësi. Ky Këshillë përbëhet nga kryetari i komunës i cili e kryeson, komandanti i stacionit policor në Malishevë, nga një përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetare në Malishevë, nga një përfaqësues të secilit komunitet etnik në Malishevë, kryesuesi i komitetit për komunitete të kuvendit të komunës, zyrtari për barazi gjinore, drejtori i drejtorisë për arsim, kryetari i këshillit të prindërve të arsimit në Malishevë, një përfaqësues i FSK-së, një përfaqësues i secilit këshill lokal për siguri publike, kryesuesi i ekipit veprues për siguri në bashkësi, një përfaqësues nga sektori i emergjencave civile komunale, përfaqësuesi zyres komunale për komitete dhe kthim dhe një përfaqësues i organizatave joqeveritare, mediat lokale, komiteti biznesit dhe komiteti i personave me aftësi të kufizuara.

Ky këshill ka 5 objektiva kryesore: rritjen e vetëdisimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullësit dhe sjelljet e dhunshme të komunitetit në lokacion, identifikimin e brengave lidhur me sigurin publike, rekomandimet e planeve të veprimit dhe adresimin e

brengave të qytetarëve për komunitetet komunale, ndërtimi i besimit në mes të policisë dhe qytetarëve, nëpërmjet partneritetit dhe inicjativave të përbashkëta në zgjedhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi dhe përfaqësimi i pikëpamjeve dhe shqetësimeve të të gjithë qytetarëve për çështjet e krimit dhe çështjet tjera që lidhen me kualitetin e jetës së qytetarëve të komunës sonë. Të nderuar asambleistë duke qenë në dijeni se themelimi i këtij këshilli është obligim ligjor dhe kërkoj nga ju që të aprovohet. Faleminderit!

Argjend Thaçi: Faleminderit, kryetar! Urdhëro Nebih!

Nebih Bibaj: Për pjesët e FSK-së, komandantit të stacionit, bashkësisë fetare kjo pjesa është në rregull, mirëpo të OJQ-të dhe mediat lokale secili nga ne duhet ta dimë emrin e personit dhe jo të votohet në pako. Kisha dashur të di se kush do të jetë përfaqësuesi nga OJQ-të dhe mediave lokale.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Ne si Vetëvendosje pajtohemi që përbërja të jetë prej këtyre institucioneve, OJQ-ve dhe media, mirëpo, paraprakisht kisha pasur dëshirë t'i kemi emrat e përfaqësuesve që vinë nga fusha e medias dhe Organizatave Joqeveritare. Për policinë, komitetet fetare jemi në rregull. Ne e votojmë në parim kërkesën e kryetarit me këtë përbërje të institucioneve, ndërsa në një seancë tjetër t'i votojm dhe pakon e emrave se kush janë përfaqësuesit e këtyre institucioneve.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Faleminderit, kryesues! Këto propozime, mediat lokale, komiteti biznesit, komiuniteti i personave me aftësi të kufizuara, propozimet a i jep qeveria lokale apo kuvendi. Nëse na lejohet që ne si kuvend të propozojm emrat, unë propozoj që të jetë e njejta antare Feride Hoxha.

Nebih Bibaj: A ka ndonjë sqarim për këta emra.

Ekrem Kastrati: Ky vendim është miratuar në bazë të Udhëzimeve Administrative. Nëse ka propozim konkret si rasti i Valonit, shkojnë në votime dhe në një farë forme eliminohen vërejtjet. Ne nuk i kemi emrat e institucioneve të tjera, as të komiteteve fetare dhe as të komiteteve tjera, kështu që është mirë emrat të zëvendësohen me një seancë tjetër.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban!

Alban Kastrati: Faleminderit, kryesues! Ne si grup i PDK-së propozojmë Habib Zogaj që të jetë pjesë e këtij Këshilli dhe besoj se është një figurë kredibile që e ka dëshmuar dhe gjatë periudhës së luftës anën profesionale gazetareske.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Shumica e institucioneve antarët i caktojnë vetë. Meqenëse na dulen dy propozime është mirë që ta vojmë këtë komision në parim, e pastaj i votojmë veq e veq dy propozimet që i kemi për përfaqësim në këtë komision.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Më mirë është që këta emra të vinë prej institucioneve dhe të jetë në kompetencë të tyre kush po vjen prej mediave dhe prej OJQ-ve. Nëse ne propozojmë për OJQ-të, kjo nuk po vjen prej OJQ-së, por po vjen prej kuvedit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Unë kërkoja sqarim nga ju, a duhet të votohet në kuvend apo propozimet vin prej tyre. Është mirë si fillim të na jepet ky sqarim dhe nëse kërkohet prej OJQ-ve, atëherë le të mbetet atje. Unë e thash që në çoftëse duhet që kuvendi të jap propozime atëherë propozova Feride Hoxha.

Argjend Thaçi: Urdhëro, kryetar!

Ekrem Kastrati: Është 1.5 përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komiteti biznesit dhe komiteti i personave me aftësi të kufizuara. Nuk bëhet fjalë vetëm për OJQ-të por për gjithë këtë komitet i cili është i përfshirë me një përfaqësues. Ju po kërkon propozim direkt dhe unë nuk mundem me ju ndalu juve me pas propozime, është çështje e juaja se kë e propozoni. Në parim do të duhet që kjo shkresë të aprovohet si e tillë dhe pastaj të zëvendësohet me emrat që vin nga komunitetet.

Argjend Thaçi: E hedhim në votim si parim e pastaj ju takon komiteteve që t'i sjellin emrat. Kush është për?

Për: 27

Kalojmë në pikën e 6. Formimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve për stacionin e autobusëve në Malishevë. Ky komision përbëhet nga dy përfaqësues nga asamblea komunale dhe një përfaqësues nga zyra e kryetarit. Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Kryesues, pauz nuk marrën.

Argjend Thaçi: Veton, është vetëm dhe një pikë dhe e përfundojmë. Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Ky komision është shumë i rëndësishëm duke marr parasysh gjendjen në të cilën gjendet stacioni i autobusëve në Malishevë. Unë kam qenë antarë i komisionit për dy vite. Ne si komision jemi munduar ta bëjmë punën tonë, por kemi hasur në probleme të thella, të jashtëzakonshme dhe pa një mbështetje të ekzekutivit të atëhershëm komunal. Ndoshta unë po mendoj që e keni prej vullentit të mirë që t'i shtyni gjërat përpara në këtë stacion, që e keni marrur këtë formim të këtij komisioni me kaq nguti. Unë besoj në këtë parim. Nuk po dua të besoj në pjesën tjetër që doni me marr një hapë për formimin e këtij komisioni dhe me rahatu ndonjë individ që ju ka dëshpru në procesin zgjedhor të cilin nuk keni mundur me rahatu nëpër

pozita të ndryshme. Stacioni i autobusëve gjendet në gjendje të mjerushme. Raportet të cilat ne i kemi shikuar aty në stacionin e autobusëve janë për keqardhje. Ai stacion është drejt falimentimit. Aty ne i kemi themeluar disa organe, e kemi themeluar dhe bordin, e kemi themeluar dhe kryetarin e bordit menaxherin, por nuk ka qenë funksional asnjëherë, sepse ka hasur në barrier të mëdha nga qeveria e atëhershme. Ne me vendime të kuvendit kemi ndarë dhe mjete rregullimin e zyreve dhe pagesën e antarëve të bordit dhe asnjëherë nuk ka ndodhur ajo. Pse nuk ka ndodhur duhet ekzekutivi të na sjellë përgjigjen.

Kjo ndërmarrjet publike që është në buzë të falemintimit, është si pasojë e mos bashkëpunimit të kryetarit të komunës së atëhershme me komisionin komunal të Aksionarëve. Kryetari i komunës asnjëherë nuk e ka sjellë përfaqësuesin e tij në këtë komision. Unë, uroj që ky komision i cili zgjedhet t'i adreson gjërat dhe nëse kanë nevojë mund të konsultohen me mua për arsye dhe çështje se deri ku i kemi dërguar ne, por asnjëherë mos të tërhiqen për gjëra që kanë ndodhur aty, sepse duke u tëhequr ju shkakton dëm më shumë aty.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Ky komision është shumë i rëndësishëm dhe është shumë mirë që ekzekutivi e ka propozuar këtë në fillim të mandatit. Besoj që ky komision që do e zgjedhim sot, do të zgjidhet krejtësisht në baza ligjore. Kur është zgjedhur ky komision në mandatin e kaluar, është zgjedhur në mënyrë kundërligjore. Ai komision ka funksionuar shumë në baza politike. Ai komision ka pas emru antarë të bordit, ku secila parti i ka ndarë ka dy antarë të bordit, njerëz politikë dhe Lëvizja Vetëvendosje dhe PDK-ja. Shpresoj që emrimi i këti komisioni të merr shpejtë masën për themelimin e një bordi, zgjedhjen e një kryeshefi ekzekutiv, dhe të fillohet të vendoset në via të drejta kjo ndërmarrje publike.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Sa i përket këti kolegut, nëse ka një fakt që është themeluar komisioni brenda kuvendit dhe e ka kthyer ligji ose kemi qenë në kundërshtim me ligjin, unë jam këtu dhe do t'i përgjigjem në çdo formë. Ky komision ka funksionuar në baza të mira, për një të ardhme të stacionit të autobusëve. Komisioni është themeluar në kuvend, ka marrur një vendim të kuvendit, pse nuk e ka dërguar ekzekutivi, kryetari i atëhershëm përfaqësuesin e tij në atë komision është çështje e tij, sepse nuk ka dashur që gjërat të dalin në pah. Po t'i kishte dhe antarët e kuvendit në atë komision jam i sigurt se do e kishte dërguar përfaqësuesin e tij.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Ne këtu po flasim për ndërmarrjen e vetme publike të komunës së Malishevës, e cila është në një gjendje për keqardhje. Ish kryetari Begaj në atë kohë kur ndërmarrja publike është kthyer në menaxhim nga komuna e Malishevës, është mburrur se është vendim i tij dhe tash po fillon fuqizimi i saj dhe kjo do t'i shërbej qytetarëve të komunës së Malishevës, për hapjen e mundësive të mira për ringjalljen e kësaj ndërmarrje dhe realisht ndodhi e kundërta. Kryetari Begaj e ka pamundësu dhe një komision të vetëm, cili do t'i hedhte hapat e parë apo

gurthemelin e rifillimit të punës së kësaj ndërmarje. Atë kohë e sabotoj komisionin e Akasionarëve, vetëm pse ishin dy përfaqësues që kuvendi i kishte votuar dy përfaqësues të opozitës dhe në asnjë variant nuk e sjelli përfaqësuesin e tij. Në këtë komision e kemi pasur përfaqësuesin tonë dhe kam qenë i informuar në detaje për situatën në të cilën kanë hasur aty. Aty kemi pasur të bëjmë me një keqmenaxhim e cila ka vazhduar për një kohë të gjatë dhe moslllogaridhënie prej përfaqësuesve që kanë menaxhuar me stacionin e autobusëve. Kemi një projekt që e ka sjellë ish-qeverisja dhe tani dhe kjo që ka vazhdu me një projekt i cili ka ndërhyrë në pronën e stacionit të autobusëve, ka ndërhyrë mbi objektin ekzistencial të stacionit të autobusëve duke e sjellë një projekt që është quajtur inkupator i biznesit, që asnjëherë nuk është realizuar. Janë të gjitha këto shkelje të cilat i faturohen qeverisjes së deritanishme. Tani jemi në një situatë ku do ta rithemelojm një komision të aksionarëve dhe uroj që përfaqësues të këtij komisioni të bëjnë një raport të gjendjes së si është stacioni i autobusëve, të bëhet një raport i detajuar ku paraqesin shkeljet që janë bërë aty. Sot stacioni i autobusëve nuk ka as llogari bankare, sepse ja ka bllokuar ATK-ja, për shkak të mos menaxhimit të mirë dhe mos deklarimit me kohë të të hyrave dhe të dalurat e financave nga kjo ndërmarrje. Propozimet që i jep kuvendi, uroj që të jenë më të duhurit dhe me njerëz që punojnë në këtë drejtim.

Argjend Thaçi: Shkojmë me propozime. Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: Unë uroj që në kuadër të këtij komisioni të jenë propozimet e qëlluara dhe këta persona që do jenë pjesë e kësaj të kenë kompetenca. Unë kisha kërkuar nga shefi i Vetëvendosjes të na tregoj se cilat projekte nga niveli qendror janë për Malishevën? Unë po ju betohem se nuk ka asnjë projekt për komunën e Malishevës. Këta gjithmonë kanë qenë kundër projekteve të Malishevës, kundër inkupatorit, kundër shkollës, kundër tranzitit dhe kundër çdo projekti që është ardhur nga niveli qendror këta kanë qenë kundër. Tani që e kanë pushtetin, asnjë projekt nuk e kanë futur në buxhetin 2022 për komunën e Malishevës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj.

Veton, Zogaj: Është e pa vërtet kjo që po thua, që Vetëvendosja ka qenë kundër inkupatorit të biznesit. Ne kemi qenë kundër uzurpimit të pronës. Ne kemi thënë që një projekt që ka ardhur nga niveli qendror me u ndërtu ka hapsira publike, të cilat mundeni me i shfrytëzu si komunë. Ju keni bërë uzurpim të pronës. Për projektet e nivelit qendror ne këtu do të jemi 4 vite dhe do t'i diskutojm. Vetëm menaxhoj t'i mirë dhe do të ketë projekte sa të duash.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Mazreku: I nderuar Veton çdo seancë e kuvendit e ka ingjizimin dhe mund ta shikosh se ish shefi i grupit të Vetëvendosjes ka thënë që ky projekt më mirë kishte qenë me shku në Dragash se sa në Malishevë. Ne buxhetin e vitit 2021 por dhe në buxhetin e vitit 2022 asnjë projekt nuk është për Malishevën. Niveli qendror mundet që kompetencat për mbikqyrje të projektit të nivelit komunal, por mund t'i bart dhe komplet kompetencat vetë si investitor. Është

rasi i shkollës së Dragobilit dhe shkollës së Malishevës, ata komplet e kanë menaxhuar implementimin projektin.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Për projekte e investime nga niveli qëndor i diskutojmë në seancat kur ka pika të rendit të ditës. Nuk kemi qenë kundër asnjëherë, mirëpo kemi qenë që ky projekt të jetë në zonë publike, ka prona publike komuna e Malishevës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Për antarë të Komisionit të Aksionarëve të stacionit të autobusëve propozoj Jahir Xhyliqin.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Ne si grup parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, për antarë të Komisionit të Aksionarëve propozojmë Burim Paçarizin.

Argjend Thaçi: Urdhëro Valon!

Valon Krasniqi: Për antarë të Komisionit të Aksionarëve propozoj Arlind Morina.

Argjend Thaçi: Propozimi i parë është Jahir Xhyliqi. Kush është për?

Për: 15

Kundër: 0

Abstenim: 12

Me 15 vota për, asnjë kundër dhe 12 abstenime, Jahir Xhyliqi bëhet pjesë e Komisionit të Aksionarëve

Propozimi i dytë është Burim Paçarizi. Kush është për?

Për: 12

Kundër: 14

Abstenim: 1

Me 12 vota për, 14 kundër dhe 1 abstenim propozimi i PDK-së nuk kalon

Propozimi i tretë është Arlind Morina. Kush është për?

Për: 15

Kundër: 11

Abstenim: 1

Me 15 vota për, 11 kundër dhe 1 abstenim Arlind Morina bëhet pjesë e Komisionit të Aksionarëve

Komisioni Komunal i Aksionarëve për Stacionin e Autobusëve në Malishevë përbëhet nga Jahir Xhyliqi, Arlind Morina dhe një përfaqësues nga kryetari i komunës.

Shkojmë në votim që ky komision të votohet në tërsi. Kush është për?

Për: 15

Kundër: 9

Abstenim: 3

Me 15 vota për, 9 kundër dhe 3 abstenime, formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Stacionin e Autobusëve në Malishevë.

Kalojmë në pikën të ndryshme. Urdhëro, Nebih!

Nebih Bibaj: Ka shumë rëndësi që këto komisione u themeluan sot, sepse i parasheh dhe ligji. Ne kemi shumë çështje dhe më urgjente që t'i shtjerrim në një seancë të rregullt dhe të debatohen çështjet me rëndësi të veçantë të cilat i përkasin komunës së Malishevës.

Do ndalem te shkolla "Ganimete Terbeshi" në Astrazup, ka dy javë që procesi mësimor mbahet nga 30 min ose 1 orë. Në Astrazup ka dy javë e më shumë që nxënësit, profesorët nuk mbajnë mësim për shkak të kushteve që nuk kanë mjete djegëse. Të njejtën gjendje e kemi në shkollën në Bubavec, sepse vetëm dhe dy ditë ka dru në këtë shkollë. E njejtë gjë është në Panorc. Kjo është çështja urgjente me të cilën është dashur të merremi ne me këtë seancë. Qytetarët na kanë votuar këtu që ne të ju bëjmë zgjidhjen dhe zgjidhja jonë është që të dalim në teren dhe të shikojmë se cilat shkolla nuk kanë nxemje. Ju bëj thirrje qeveris, kryetarit drejtoreshes që të ju bëjnë zgjidhje shkollave. Kalldaja në Astrazup për 4 vite e kemi cekur, që ajo kalldaj nuk po mundet me i mbulu nevojat e asaj shkolle. Është mirë të ndërrohen gjërat me kohë sepse problemin më të madh po e kanë nxënësit. Nëse duhet një vendim i kuvendit, duhen mjetet ne jemi këtu, mirëpo nxënësit nuk kanë nevoj të hekin për shkaqe të neglizhencës së qeveris.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!


Veton Zogaj: Kryesues, ju kisha lutur që në seancat e ardhshme të jeni më të përgaditur, dëgjoje mirë rregulloren e punës së kuvendit, ku deklaratimet jashtë rendit të ditës, replikat janë të parapara me atë rregullore. T'i je kryesues, t'i je përgjegjës për mbarrvajtjen e këtij kuvendi. Në momentin që më përmendet emri dhe kam çështje për t'i ngritur të subjektit politikë më lejohet replika dhe kundëreplika. Kryesues, për seancat e ardhshme dërgona ftesën t'i ose na detyroni neve vetë që të bëjmë deklaratimet e grupeve politike, që mos të kemi këso telashe. Kryesues, ose dërgona ftesën që e ke të parapara me rregullore ose na detyroni me i dërgu vetë dhe vendimet për përjashtime të antarëve të caktuar, të grupeve politike.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlind!

Arlind Morina: Kryesues, në mbledhjen tjetër kërkoj nga ju që administrata e kuvendit të filloj punën, që kamerat të jenë në funksion dhe secili kandidatë këtu që e merr fjalën ta ketë minutazhen dhe mos të stërgjaten mbledhjet si mandatin e kaluar.

Argjend Thaçi: Këtë seancë e shpallim të mbyllur.

Procesmbajtësja:
Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit
Klodian Thaci

